



JAVA EVROPIANE PËR SHËNDETIN DHE SIGURINË NË PUNË 21-25 TETOR 2019

Fushata e BE-ASSHP¹, Punëtorja

“Klasa master në vlerësimin e rrezikut të vendit të punës,”

22 tetor 2019, 13:00 – 17:00

Qendra e Konferencave ORION, rr. Rexhep Luci, Nr.2, Prishtinë, Kosovë

Qëllimi i punëtorisë: ngritja e cilësisë së vlerësimit të riskut në vendin e punës të ofruar për bizneset në Kosovë. Fokusi kryesor do të jetë aspektet praktike të vlerësimit të riskut në vendin e punës, ku do të përfshihen puna në grup dhe loja e roleve me vende specifike të punës për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, si dhe për përcaktimin e masave të duhura parandaluese. Nuk do të ketë prezantim gjatë punëtorisë; dhe pjesëmarrësit duhet të jenë të gatshëm të marrin pjesë aktive në punën në grup, të ndajnë përvojat e tyre dhe të marrin pjesë në diskutime. Pjesëmarrësit do të inkurajohen të përfshihen në mënyrë aktive në diskutime, si dhe të përdorin metodat e tyre të përdorura për vlerësimin e riskut në vendin e punës.

Moderatorë:

Dr. Linda Matisane - eksperte e SSHP-së nga BE-ja, ish menaxhere shërbimesh të jashtme të SSHP-së (Letoni);

Dr. Ivars Vanadzins - ekspert i SSHP-së nga BE-ja, Drejtor i Institutit të Sigurisë në Punë dhe Shëndetit Mjedisor (Letoni)

AGJENDA

13:00-13:10	Hapja e punëtorisë
13:10-13:20	Caktimi i detyrave për punën në grup, shpjegimi i rregullave dhe detyrave. <i>Pjesëmarrësit duhet të marrin me vete listat kontrolluese/formularët/shabllonet/metodat e tyre! Ato nuk duhet të jenë të plotësuara!</i>
13:20-15:15	Analiza e rasteve, përfshirë punën në grup për vlerësimin e riskut dhe identifikimin e masave parandaluese.
15:15-15:30	Pushim
15:30-16:45	Prezantim i punës në grup dhe diskutime.
16:45-17:00	Sesioni i pyetjeve dhe përgjigjeve. Mbyllja e punëtorisë.

Punëtorja është falas. Prezantimet do të mbahen në anglisht, dhe do të sigurohet përkthim shqip. Do të lëshohen certifikatat e pjesëmarrjes.

Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar! Ju lutemi të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj **deri në 17 tetor, 2019**, me e-mail: zvokrri@archidata.it ose me telefon: +383 (0) 49487333

Pjesëmarrësit duhet të marrin me vete listat kontrolluese/formularët/shabllonet/metodat e tyre të përdorura për dokumentimin e faktorëve të riskut në vendin e punës! Këto dokumente nuk duhet të jenë të plotësuara para punëtorisë, sepse do të plotësohen gjatë punëtorisë!

¹ Agjencia Evropiane për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë